



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2018

PËR

DISA SHTESA NË LIGJIN NR.93/2015, “PËR TURIZMIN”, **TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 6, paragrafi numërohet me numrin 1 dhe pas tij shtohen pikat 2 e 3, me këtë përmbajtje:

“2. Përfshihet nga mbështetja dhe lehtësitë e parashikuara në kreun VI, të këtij ligji, çdo investitor/operator menaxhues kur ka të dhëna se është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:

- a) Pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;
- b) Korrupsion;

- c) Mashtrim;
- ç) Pastrim parash ose financim i terrorizmit;
- d) Vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste ose nxitje, ose ndihmë ose mbështetje për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste;
- dh) Organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit e shitjes së narkotikëve si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;
- e) Falsifikim;
- ë) Puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

Përfashtimi nga mbështetja dhe lehtësitë zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i tij, aksionar ose ortak i investitorit/operatorit menaxhues, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse apo kontrolluese brenda tij.

3. Për përfitimin e mbështetjes dhe të lehtësirave të parashikuara në kreun VI, të këtij ligji, investitori/operatori menaxhues duhet të paraqesë vërtetim nga dosja gjyqësore ose një dokument të lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni.”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI